

V E N D I M
Nr.433, datë 9.9.1999

**PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS
FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ligjit nr.8334, datë 29.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 31.8.1999 "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Forma e privatizimit e ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë do të jetë tenderi i hapur.
2. Procedurat e tenderit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 31.8.1999 "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore".
3. Vlerësimi i ndërmarrjes do të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shoqërore që privatizohet dhe procedura e shitjes".
4. Kriteret bazë të vlerësimit të ofertave do të jenë:
 - a) çmimi i ofruar;
 - b) niveli i investimit të propozuar;
 - c) plani i biznesit;
 - ç) cilësia teknike e investitorit:
 - reputacioni në fushën e biznesit të prodhimit të çimentos, prodhimi të jetë jo më pak se 7 milionë tonë në vit;
 - koha gjatë së cilës ai ushtron këtë veprimtari të jetë jo më pak se 5 vjet;
 - gjendja financiare: bilancet e tre viteve të fundit;
 - aftësitë për të menaxhuar: cilësitë e stafit;
 - d) treguesit e punësimit dhe të trajnimit të stafit dhe specialistëve;
 - e) kushtet për mbrojtjen e mjedisit.
5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko